



**AKT - THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE
"MIA CONSTRUCTION 2003"SH.P.K.**

- 1- **Z.Illir Adili**, i biri i Sulejmanit, lindur ne 07.09.1961, banue sne Tirane, Rruga"NIKOLLA TUPE"pall.2,shk.1,ap.46,me numer paSAPORTE 0573000;
- 2- **Muharrem Kokona**, i biri i Baftjarit, lindur ne 12.02.1962,banues ne Tirane, Rruga"NIKOLLA TUPE" Pall.2,shk.1.ap.47,me numer pasaporte 0668317,
- 3- **Z.Arben Ismailaga**, i biri i Xhavitit, lindur ne 14.10.1961, banues ne Tirane, Rruga"Qemal Stafa"Nr.377.

me vullnetin e tyre të lirë dhe në bazë të Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", Ligjit Nr.7667 datë 28.01.1993 "Për rregjistrin tregtar" dhe Ligjit Nr.7512 datë 10.08.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private dhe nismës së lirë, veprimtarisë private dhe privatizimit" ,kanë vendosur të krijojë një Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar sipas kushteve e normave të parashikuara në Statutin e shoqërisë bashkëngjitur dhe në këtë Akt - Themelimi si më poshtë vijon:

Neni 1

Ortakët themelojn Shoqërinë Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar:
"MIA CONSTRUCTION 2003" Sh.P.K.

Neni 2

Kjo Shoqëri Tregtare do të ketë selinë e saj në Golem, ish Kampi i Rinise.
Shoqëria në bazë të legjislacionit shqiptar ka të drejtë të hapi filiale, degë, përfaqësi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj në përputhje me legjislacionin e vendeve ku ato do të hapen.

Neni 3

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë 20 vjet.
Shoqëria mund të shpërndahet edhe para këtij afati në bazë të vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë Tregtare "MIA CONSTRUCTION 2003"

1

Sh.p.k do të jetë:

1.Ne fushen e prodhimeve te ndertimit;

Prodhimin dhe tregtimin e materialeve inerte, prodhimin dhe tregtimin e betoneve te ndryshme, parafabrikateve dhe elementeve te ndertimit,prodhimin e elementeve gjysem fabrikat, prodhimin dhe tregtimin e dyerve dhe dritareve prej druri dhe duralumini,te drejten e franksionimeve te zhavorreve etj.

2.Ne fushen e ndertimit;

Punime dheu, betoni,beton arme te zakonshme, punime shembjesh, ndertime civile,ndertime industriale,turistike,bujqesore etj,e kompletuar me instalimet e nevojshme per to,punime restaurimi,punime infrastukture si shtrim rruge-beton,trotuare,punime ne kanalizimet e ujrave te zeza dhe te bardha,punime ne linjat e furnizimit me uje ne rjetet e jashteme e ne te brendshme, instalimet elektrike te rjetit te jashtem per furnizimin me energji elektrike te godinave apo veprave te ndryshme industriale, civile, kulturore etj.

3.Ne fushen e sherbimit tregtar;

Zhvillimin e aktivitetit si bar bufë,restorant, hoteleri, sallone lojrash dhe bukurie, pika turistike, plazhe private, etj.

4.Ne fushen e sherbimit;

Transport te te gjitha prodhimeve te ndertimit,transportin e mallrave dhe te udhetareve brenda dhe jashte vendit,agjensi detare, spedicionere,turistike, komisionere, te kontrollit sasior e cilesor, doganore, agjensi te pasurive te palujtshme,agjensi te ushtrimit te gjuetise sportive dhe turistike.

5.Ne fushen e tregtise;


Import eksport dhe tregtim me shumice dhe me pakice te mallrave industriale,bujqesore,materiale ndertimi, artikuj ushqimore, prodhime bujqesore dhe blegtorale, pije freskuese e alkolike, cigare, karburante, bime medicinale, pajisje hidrisanitare, kimikate, lende drusore, duralumini,automjete, goma automjetesh,makineri ndertimi,pajisje zyre, kancelari,pajisje per bar restorant, pajisje elektrike e hidraulike.

Import eksport lende te para,ndihmese,konfeksione, pelhura,stofra,fije tekstile.Prodhim konfeksionesh te ndryshme per burra, gra, femije, shitje me shumice e pakice brenda dhe jashte vendit, importin dhe tregtimin me shumice e pakice detergjentesh lares, artikuj elektronike, elektroshtepiake etj.

Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 leke.

Ky kapital është i ndarë në 100 pjesë me vlerë 100 leke secili, të renditura nga numri 1 deri në 100 krejtësisht të shlyeshme. Pjesët e kapitalit themeltar zotërohen nga



ortakët si më poshtë:

- 1- **Z.Arben Ismailaga** zotëron 50 pjesë, të renditura nga numri 1 (një) deri tek numri 50 (pesedhjetë) duke e përfshirë, që përfaqësojnë 50% të kapitalit.
- 2- **Z.Illir Adili** zotëron 25 pjesë, të renditura nga numri 51 deri tek numri 75, që përfaqësojnë 25% të kapitalit.
- 3- **Z.Muharrem Kokona** zotëron 25 pjesë, të renditura nga numri 76 deri në numrin 100 dhe që përfaqësojnë 25% të kapitalit.

Pjesët e Kapitalit Themeltar përfaqësojnë kontribute në para dhe janë shlyer plotësisht prej ortakëve.

Neni 6

Kapitali themeltar i Shoqërisë, përfaqëson kapitalin e derdhur nga Ortakët i nevojshëm për veprimtarinë e Shoqërisë. Sipas kërkesës së ligjit, **administratoret** kanë të drejtë të çelin një llogari bankare në një nga **BANKAT**, në të cilën do të depozitohet kapitali themeltar i shoqërisë në formim dhe pas formimit të shoqërisë ka të drejtën e tërheqjes së këtij kapitali themeltar.

Kapitali Themeltar mund të përbëhet edhe nga kontribute në natyrë. Në këtë rast vlerësimi i kontributeve në natyrë do të bëhet sipas N. 42 të Ligjit Nr.7638 dt.19.11.1992.

Në librin e llogarisë që do të krijohet në shoqërinë tregtare do të shënohet edhe kapitali i derdhur nga Ortakët.

Rritja e kapitalit nuk është e kufizuar.

Neni 7

Shoqëria Tregtare në marrëdhëniet me të tretët përgjigjet vetëm me pasuritë e shoqërisë, fondet e saja dhe Ortakët përgjigjen për detyrimet e kësaj Shoqërie vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 8

Shoqëria e pushon aktivitetin e saj me mbarimin e afatit të përcaktuar në këtë kontratë ose për shkaqe të tjera të përcaktuara në Statut.

Fitimi neto ndahet sipas pjesëve të kontributit në kapitalin themeltar.

Neni 9

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- **Asambleja e Ortakëve**
- **Administratori.**

Administratorët emërohen e shkarkohen prej Asamblesë së Ortakëve.

Administratori i Shoqërisë deri në shkarkimin e tij nga Asambleja e Ortakëve do të jete **Z.Muharrem Kokona.Kopetencat e Administratorit jane te percaktuara ne Statutin e Shoqërisë.**

Modalitetet për përbërjen dhe funksionimin e organeve të mësipërme përcaktohen nga

3

statuti i Shoqërisë si dhe nga Ligji “Për Shoqëritë Tregtare”.

Neni 10

Ortakët janë të detyruar të ruajnë sekretin e dokumentacionit, informacionit, njohjeve dhe të eksperiencës së këmbyer e të realizuar brenda Shoqërisë dhe të marrin të gjitha masat për të evituar përhapjen e tyre qoftë dhe në mënyrë të pjesëshme.

Ortakët janë përgjegjës për pasojat e dëmshme, të shkeljeve ndaj ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve do të bëhet konform normave të konventave ndërkombëtare për rregullimin e mosmarrëveshjeve në Shoqëritë Tregtare, në Gjykatën e Rrethit Tiranë.

Neni 12

Më të detajuara dispozitat për Shoqërinë Tregtare “MIA CONSTRUCTION 2003” Sh.P.K janë përcaktuar dhe përmbahen në Statutin e saj.

Neni 13

Kjo kontratë formulohet në katër kopje, nga të cilat njëra depozitohet në Zyrën e Noterisë Tiranë, njëra depozitohet në Gjykatën e Shkalles Pare, njëra në Zyrën e Tatimeve Tiranë dhe kopja e katërt mbahet në dokumentat e Shoqërisë.

Kontrata është e vlefshme që nga momenti i nënshkrimit të saj nga ortakët.

ORTAKËT

1. *Arben Ismaili*

2. *Mr. Adili Adili*

3. *Arben Ismaili*

S T A T U T I
SHOQËRISË TREGTARE
“MIA CONSTRUCTION 2003” SH.P.K.

Shoqëria Tregtare me përgjegjësi të kufizuar “MIA CONSTRUCTION 2003” Sh.P.K, është krijuar sipas kontratës për themelimin e saj nga ortakët **z.Illir Adili, Muharrem Kokona dhe Arben Ismailaga.**

Për të bërë të mundur veprimtarinë ekonomike dhe organizimin e kësaj Shoqërie në përputhje me Ligjin Nr.7638 datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare”, Ligjit Nr.7667 datë 28.01.1993 “Për rregjistrin tregtar”, është përpiluar ky Statut sipas kërkesave të Ligjit për Shoqëritë Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar si më poshtë:

KREU I PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME
(forma, emërtimi, objekti, selia, kohëzgjatja)

Neni 1

Ortakët e lartpërmendur pjesëmarrës në Kontratën e Themelimit kanë krijuar një Shoqëri Tregtare me përgjegjësi të kufizuar.

Shoqëria Tregtare e fiton zotësinë për të vepruar si person juridik me rregjistrimin e saj në **Gjykatën e Shkalles Pare Tiranë** si dhe rregjistrimin e saj në **Rregjistrin Tregtar.**

Neni 2


- **Shoqëri emërtohet “MIA CONSTRUCTION 2003” Sh.P.K** dhe ka si objekt të saj:

1.Ne fushen e prodhimeve te ndertimit;

Prodhimin dhe tregtimin e materialeve inerte, prodhimin dhe tregtimin e betoneve te ndryshme, parafabrikateve dhe elementeve te ndertimit,prodhimin e elementeve gjysem fabrikat, prodhimin dhe tregtimin e dyerve dhe dritareve prej druri dhe duralumini,te drejten e franksionimeve te zhavorreve etj.

2.Ne fushen e ndertimit;

Punime dheu, betoni,beton arme te zakonshme, punime shembjesh, ndertime civile,ndertime industriale,turistike,bujqesore etj,e kompletuar me instalimet e nevojshme per to,punime restaurimi,punime infrastukture si shtrim rruge-beton,trotuare,punime ne kanalizimet e ujrave te zeza dhe te bardha,punime ne linjat e furnizimit me uje ne rjetet e jashteme e ne te brendshme, instalimet elektrike te rjetit te



jashtëm për furnizimin me energji elektrike të godinave apo veprave të ndryshme industriale, civile, kulturore etj.

3. Ne fushën e shërbimit tregtar;

Zhyllimin e aktivitetit si bar bufe, restorant, hoteleri, sallone lojërash dhe bukuri, pika turistike, plazhe private, etj.

4. Ne fushën e shërbimit;

Transport të të gjitha prodhimeve të ndërtimit, transportin e mallrave dhe të udhëtareve brenda dhe jashtë vendit, agjensi detare, speditonere, turistike, komisionere, të kontrollit sasior e cilësor, doganore, agjensi të pasurive të palujtshme, agjensi të ushtrimit të gjestive sportive dhe turistike.

5. Ne fushën e tregtisë;

Import eksport dhe tregtim me shumicë dhe me pakicë të mallrave industriale, bujqësore, materiale ndërtimi, artikuj ushqimorë, prodhime bujqësore dhe blegtorale, pije freskuese e alkoolike, cigare, karburante, bime medicinale, pajisje hidrisanitare, kimikate, lende drusore, duralumini, automjete, goma automjetesh, makineri ndërtimi, pajisje zyre, kancelari, pajisje për bar restorant, pajisje elektrike e hidraulike.

Import eksport lende të para, ndihmese, konfeksione, pelhura, stofra, fije tekstili. Prodhim konfeksionesh të ndryshme për burra, gra, femije, shitje me shumicë e pakicë brenda dhe jashtë vendit, importin dhe tregtimin me shumicë e pakicë detergjentesh larës, artikuj elektronike, elektroshtepiake etj.

• Për përmbushjen e këtij objekti shoqëria mund të krijojë ose të marrë pjesë në shoqëri të tjera me objekt të njëjtë ose të përafërt.

Shoqëria në bazë të legjislacionit shqiptar ka të drejtë të hapë filiale, degë, përfaqësi dhe të japë përfaqësimin në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj në përputhje me legjislacionin e vendeve ku ato do të hapen.

- **Selia e shoqërisë tregtare** ndodhet në Golem ish Kampi i Rinise.
- **Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë tregtare** është parashikuar për një periudhë 20 vjeçare me të drejtë ripërtëritje.

Ky afat mund të zgjatet ose të zvogëlohet sipas propozimeve të bëra nga ortakët dhe pasi të vendoset nga Asambleja e Ortakëve.

KREU II



KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 3

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare është 100.000 leke. Ky kapital është i ndarë në 100 pjesë me vlerë 100 leke secila, të renditura nga numri 1 deri në 100 krejtësisht të shlyeshme. Pjesët e kapitalit themeltar zotërohen nga ortakët si më poshtë:

- 1- Z.Illir Adili zotëron 25 pjesë, të renditura nga numri 1 (një) deri tek numri 25 , që përfaqësojnë 25% të kapitalit.
- 2- Z.Muharrem Kokona zotëron 25 pjesë, të renditura nga numri 26 deri tek numri 50, që përfaqësojnë 25% të kapitalit.
- 3- Arben Ismailaga zotëron 50 pjesë të renditura nga numri 51 deri në numrin 100.

Pjesët e Kapitalit Themeltar përfaqësojnë kontribute në para dhe janë shlyer plotësisht prej ortakëve.

Pjesët e Kapitalit Themeltar mund të përfaqësojnë kontribute në para ose në natyrë, por asnjëherë kontribute në shërbime.

Kur pjesët e kapitalit përfaqësojnë kontribute në natyrë vlerësimi i tyre bëhet nga një ekspert për kontributet nëpërmjet një raporti që i bashkangjitet statutit. Eksperti caktohet me unanimitet nga ortakët.

Shoqëria mund të zmadhojë ose zvogëlojë kapitalin e saj.

Neni 4

ZMADHIMI I KAPITALIT

Zmadhimi i kapitalit bëhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.


Zmadhimi i kapitalit me anë të nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontribute në para, bëhet sipas paragrafit të fundit të nenit 40 të L.Nr.7638/19.11.1992.

Zmadhimi i kapitalit plotësisht ose pjesërisht me anë të kontributeve në natyrë, bëhet sipas kërkesave të nenit 42, paragrafi i parë i L.Nr.7638/19.11.1992. Megjithatë eksperti i autorizuar për kontributet emërohet me vendim të gjykatës sipas kërkesës së administratorit.

Neni 5

ZVOGËLIMI I KAPITALIT

Zvogëlimi i kapitalit vendoset nga Asambleja e Ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.



Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, të paktën 45 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë të thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti.

Ekspertët i bëjnë të ditur asamblesë vlerësimin e tyre për arësyet dhe kushtet e zvogëlimit.

Neni 6

TRANSFERIMI I Pjesëve të Kapitalit

- Pjesët e kapitalit Themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Gjithashtu janë lirisht të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet parardhëseve e pasardhësve.
- Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në Shoqëri, vetëm me miratimin e shumicës së Ortakëve që përfaqësojnë të paktën 3/4 e pjesëve të kapitalit themeltar.

Në rast se shoqëria nuk bën të ditur vendimn e saj brenda tre muajve nga data e njoftimit, miratimi i transferimit konsiderohet i dhënë.

Në rast se shoqëria refuzon të japë miratimin e transferimi, ortakët brenda tre muajve nga data e refuzimit, duhet të blejnë ose të lejojnë blerjen e pjesëve të kapitalit.

- Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

KREU I DYTË

ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI


Neni 7

Organi vendimor i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.

Vendimet merren nga Asambleja ose në mbledhjet e saj, ose pas konsultimit me shkrim të ortakëve, në rast se të gjithë ortakët miratojnë me shkrim përmbajtjen e konsultimit.

Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve thirret nga një ose disa Ortakë që përfaqësojnë të paktën 10% të pjesëve të Kapitalit Themeltar.

Ortakët lajmërohen me letër rekomande të paktën 15 ditë përpara mbledhjes së

4 

asamblesë. Në këtë letër njoftohet rendi i ditës.

Lajmërimi bëhet nga administratori.

Neni 8

Secili Ortak ka të drejtë të marri pjesë në mbledhjet dhe vendimet e Asamblesë. Çdo ortak disponon një numër votash në proporcion me pjesën që ai zotëron në Kapitalin Themeltar.

Në ushtrimin e të drejtës së tyre, për të marrë pjesë në vendime çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga bashkëshorti, një person tjetër i zgjedhur prej tij si dhe me avokat.

Neni 9

Asambleja e Ortakëve vendos për bilancin vjetor, për ndryshimet në statut, për shtimin dhe pakësimin e kapitalit themeltar, për emërimin e shkarkimin e administratorit, për emërimin e ekspertëve kontabël, për pushimin, për hapjen e degëve, përfaqësive dhe filialeve në rrethet e tjera, për transferimin e shoqërisë në një formë tjetër, për zgjatjen e afatit etj.


Sipas rëndësisë së vendimeve mbledhjet e asamblesë mund të jenë të zakonshme ose të jashtëzakonshme:

- **Asambleja e zakonshme** me shumicë votash, vendos për çështje të tilla si emërimi ose shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likujduesve, miratimi i raporteve të administrimit dhe kontrollit, miratimi i llogarive vjetore dhe ndarjes së fitimit etj.

Mbledhja është e vlefshme në rast se në të janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë më tepër se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar. Në rast se nuk sigurohet kjo shumicë, ortakët thirren ose sipas rastit konsultohen për herë të dytë dhe vendimet merren me shumicën e votave të dhëna, pavarësisht nga përqindja e kapitalit që përfaqësojnë.

- **Asambleja e jashtëzakonshme** vendos për çështje të tilla si ndryshimi i statutit, zvogëlimi i kapitalit themeltar, transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar tek të tretët, zgjatja e kohës së veprimtarisë së Shoqërisë apo likuidimi i saj, shndërrimi i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në një shoqëri të formave të tjera.

Këto vendosen nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 3/4 e kapitalit themeltar.



Neni 10

Vendimet e marra nga Asambleja e Ortakëve në mbledhjet e zakonshme e të jashtëzakonshme, në përputhje me këtë Statut, janë të detyrueshme e të zbatueshme për secilin Ortak.

Asambleja e Ortakëve mbledhjet e zakonshme i bën çdo vit brenda katër muajve nga mbyllja e veprimtarive financiare të Shoqërisë.

Neni 11

Administratorët emërohen e shkarkohen nga Asambleja e Ortakëve me vendim të ortakëve që përfaqësojnë më tepër se gjysmën e pjesëve në kapitalin themeltar.

Administratorët mund të zgjidhen edhe jashtë bashkësisë së ortakëve.

Neni 12

Shoqëria administrohet nga **Z.Muharrem Kokona**.

Neni 13

Administratori ka këto kompetenca:

- 1- Të përfaqësojë shoqërinë dhe të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme përpara organeve të administratës shtetërore (taksa, tatime, dogana, ministri, ente të ndryshme shtetërore etj.) dhe atyre gjyqësore të të gjitha shkallëve.

Neni 14

Aktet e administratorit që tejkalojnë kompetencat e administratorit duhet të autorizohen nga Asambleja e Ortakëve.

Klauzolat e statutit që kufizojnë kompetencat e administratorit duhet të respektohen nga të tretët.

Neni 15

Administratorit ose ortakëve që nuk janë persona juridikë nuk u lejohe të kontraktojnë në çfardolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj për paradhënie si dhe të bëhen dorëzanës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.



Kjo masë është e vlefshme edhe për përfaqësuesit ligjorë të ortakëve që janë persona juridikë, si dhe bashkëshortëve, paraardhësve dhe pasardhësve të përmendur në paragrafin e parë të këtij neni, si dhe ndaj çdo personi ndërmjetës.

Neni 16

Administratorët janë përgjegjës individualisht ose solidarisht, sipas rastit, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Neni 17

Administratori shkarkohet nga vendim të ortakëve që përfaqësojnë më tepër se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar si dhe nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesën e çdonjërit prej ortakëve.

Neni 18

Llogaritë vjetore, inventari, raportet e operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratorët dhe eventualisht nga eksperti kontabël, miratimi i bilanceve dhe i dokumentacionit mbi veprimtarinë vjetore, teksti i vendimeve të propozuara, si dhe nëqoftëse është nevoja, raporti i ekspertëve kontabël të autorizuar, u komunikohen ortakëve dhe vihen në dispozicion të tyre në selinë e shoqërisë të paktën 15 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë.


Ortakët kanë të drejtë të marrin në çdo moment dokumentat e sipër përmendura për 3 vitet e fundit financiarë. Ata mund të ndihmohen nga një ekspert i zgjedhur prej tyre, i cili i nënshtrohet detyrimit për ruajtjen e sekretit.

Neni 19

Kontrolli i Shoqërisë kryhet nga një ekspert kontabël i autorizuar, i emëruar për çdo vit financiar me mundësi rizgjedhje. Ai caktohet nga mbledhja e Asamblesë së Ortakëve me shumicë votash.

Neni 20

Për punonjësit që do të punësohen në Shoqërinë Tregtare do të zbatohen aktet ligjore dhe nënligjore të dala për këtë qëllim duke lidhur kontratat e punës me secilin për një afat jo më shumë se një periudhë 1 vjeçare.



Paga e punës nuk është e kufizuar por ajo nuk mund të jetë më e ulët se ajo e përcaktuar me vendime të veçanta të Qeverisë.

KREU I TRETË

MARRËDHËNIET EKONOMIKO FINANCIARE

Neni 21

Viti financiar fillon më datën 1 Janar dhe mbaron më datën 31 Dhjetor të çdo viti, përveç vitit të parë që fillon me marrjen e Licenses.

Llogaritë vjetore, inventari, raportet e operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratorët dhe eventualisht nga eksperti kontabël, miratimi i bilanceve dhe i dokumentacionit mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Neni 22

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimit, **Asambleja e Ortakëve** përcakton pjesën që i takon mbi fitimin, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për fondin rezervë të domosdoshëm (jo më pak se 1/20 e fitimit të çdo viti, deri sa ky fond të arrijë vlerën e 1/10 të kapitalit themeltar) si dhe të jenë zbritur ose i janë shtuar respektivisht humbjet e mbartura apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

Neni 23

Llogaritë ekonomike dhe ato kontabël mbahen në gjuhën shqipe, në lekë ose në valutë të huaj.

Veprimtaria ekonomike mbahet në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore të dala për këtë qëllim dhe mbështetet në aktivin dhe pasivin që detyrimisht do të pasqyrohen në bilancet e përpiluara nga ekspertët kontabël të autorizuar të cilët mbajnë përgjegjësi ligjore për punën e tyre.

Neni 24

Shoqëria Tregtare me qëllim që ta bëjë sa më të lehtë dhe më të shpejtë pagesat me të tretët do të hapë llogari bankare në Bankat që janë të njohura nga Shteti Shqiptar vendase ose të huaja.

KAPITULLI I KATËRT

ZGJATJA E AFATIT, PRISHJA, LIKUJDIMI

Neni 25

Me mbarimin e afatit të përcaktuar në kontratën e themelimit zgjatja e tij bëhet vetëm me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.

Ajo prishet kur mbaron afati i përcaktuar dhe Ortakët nuk kanë rënë dakort që të bëjnë ripërtëritjen e këtij afati.

Shoqëria mund të shndërohet në një nga format e përcaktuara nga ligji dhe në formën e kërkuar nga ligji.

Neni 26

Shoqëria Tregtare hyn në procesin e likujdimit që në momentin e vendosjes për prishjen e saj. Për fillimin e këtij procesi Asambleja e Ortakëve emëron një likujdues i cili paraqet raportin e likujdimit, gjendjen e aktivitetit të pasivitetit të Shoqërisë, mbi mënyrën e ndjekjes së operacionit të likujdimit dhe afatin e nevojshëm për përfundimin e tyre.

Në fund të procesit të likujdimit, Asambleja e Ortakëve, vendos mbi bilancin përfundimtar, mbi aktin dhe rregullsinë e likujdimit, mbi mbylljen e procesit të likujdimit të Shoqërisë.



Neni 27

Të gjitha mosmarrëveshjet që do të lindin ndërmjet Ortakëve ose në marrëdhëniet me të tretët, gjatë ekzekutimit të këtij statuti dhe kontratës së themelimit, gjatë ekzistencës së Shoqërisë si gjatë kryerjes së veprimtarisë ashtu dhe në procesin e likujdimit do të drejtohen për gjykim Gjykatës së Shkalles Pare Tiranë.

Neni 28

Ky statut është hartuar në katër kopje, njëra kopje depozitohet në Zyrën e Noterisë, njëra në Gjykatën e Rrethit Tiranë, njëra në zyrën e tatimeve dhe kopja e fundit mbahet në dokumentat e krijimit të Shoqërisë.

ORTAKËT

Arben Ismailopy 
Muhareme Kaborina 
Igor Adishi 